Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës
Press Council of Kosovo
Savet Štampe Kosova

28.05.2021, Prishtinë,
Ref:06.04.2021\1126-2021

Vendim i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës ndaj ankesës së Demira Krujezit kundër Indeksonline

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës në mbledhjen e tij të mbajtur më 18 maj 2021, shqyrtoi ankesën e dërguar nga Demira Krujezi kundër Indeksonline lidhur me publikimin e artikullit me titull: "Gjendet i vrarë një person në Istog, zbulohet identiteti i viktimës", dhe mori këtë

V E N D I M

- Ankesa miratohet.

A R S Y E T I M I

Ankesa ka të bëjë me shkrimin e publikuar në portal me titull "Gjendet i vrarë një person në Istog, zbulohet identiteti i viktimës'', dhe pretendimin se bënë shkelje të kapitullit VII Privatësia të Kodit të mediave të shkruara.

Lajmi është shkruar në portal të lajmeve dhe objekt i kësaj ankese është teksti i shkruar, e që rrjedhimisht ankesa është e lejueshme për trajtim dhe e afatshme.

Pas leximit të ankesës KMShK gjen se ankesa është e bazuar.

Media ka publikuar emrin dhe fotografinë e personit që është gjetur i vrarë në një fshat të Kosovës. Sikur personi të ishte person publik dhe i njohur për publikun, atëherë publikimi i emrit dhe i fotove do të ishte në interesin e publikut, por në rastin konkret, publikimi i fotografisë dhe i emrit të viktimës nuk është interes publik dhe se media në momentin e publikimit ka bërë ndërhyrje në jetën e viktimës dhe mund të ketë ndikuar negativisht edhe tek familjarët e viktimës.

Andaj KMShK, konsideron se ankesa është e bazuar, pasi ka shkel Kapitullin VII(Privatësia) të Kodit të Mediave.

KMShK vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës